



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIC - MUNICIPALITY OF OBILIC



Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008), Statutit të Komunës, nenit 81 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-237, Ligjin nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092, dhe kërkesës nr.XIII-94 datë 11.05.2022 nga Zyra e Prokurimit, me datë 11.05.2022, nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Emërohet menaxher i kontratës (projektit) Hamit Mjeku për projektin "Ndërtimi i objekteve dhe renovimi i hapësirave për komunitete-Kubëzimi i trotuarit dhe hyrjes së xhamisë në Graboc të Epërm" me nr. të prokurimit: 614 22 012 521.
- II. Punët do të kryhen nga operatori ekonomik: N.N.T. "Korabi" Cikatovë e vjetër.
- III. Menaxherët e projektit kanë për detyrë të plotësoj planin për menaxhimin e kontratës ku specifikohen të gjitha përgjegjësitë e tyre, sipas nenit 81 të LPP-së.
- IV. Menaxherët e projektit për punën e tyre duhet t'i raportojnë Drejtorisë së DSHPE-së, DEFZH-së dhe menaxherit të prokurimit.
- V. Punimet kryhen brenda 90 ditë nga hyrja në fuqi e kontratës.

T'i dorëzohet:

- Kryetarit,
- DAP;
- DIL;
- Menaxherit të projektit;
- Zyrës së Prokurimit;
- Arkivit.



Kryetari i Komunës

Xhafer Gashi